

## AKT THEMELIMI

### DHE

## STATUTI

### I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### STAR CLOUD SH.P.K

Në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, e shprehur në nënshkrimin e aktit të themelimit, Z.IULIU BARTUS, lindur më 31.03.1976 me nr. Karte identiteti nr. ZS 182987 dhe Numer personal 1760331260017, lëshuar më 14.04.2021 deri më 31.03.2031, me adresë në: Ludus 545200, Tineretului str.1, Mures – RUMANIA

nënshkruan statutin si mëposhtë vijon:

#### NENI 1

#### EMËRTIMI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

Emri i shoqërisë është STAR CLOUD

#### NENI 2

#### SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë është në Njësia Administrative nr.10

Rr."Sami Frasheri" P.Titan Konstruksion, K. 10, Nr.34 - Tiranë.

#### NENI 3

#### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e shoqërisë është pa afat. Shoqëria do të marrë personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë.

## NENI 4

### OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka për objekt social – në limitet dhe në respektim të normativës në fuqi kohë pas kohe – aktivitetin e renditur më poshtë:

- Në fushën e imort – exportit,
- Instalim servera dhe clouds, aktivitete shërbimi për teknologjitë e informacionit,
- Ndërtimi i sistemeve të energjisë se gjelber (hidroenergji, energji djellore, energji e erës), përgatitja e sistemeve, importi i paisjeve.
- Tregtinë e gurëve të cmuar dhe bizhuterive,
- Agjensi imobiliare
- Në fushën e dhënies me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, në përgjithësi administrimin e tyre.
- Ndërmjetësim financiar midis paleve tregtare,
- Konsulencë në fushën e biznesit dhe turizmit,
- Ndërmjetësim dhe organizim të grupeve dhe individëve nga vende të ndryshme, për turizëm në Shqipëri.

Të gjitha aktivitetet do të zhvillohen brenda vendit, në Europë ose vende të tjera. Në objektin social përfshihet zhvillimi i çfarëdolloj aktiviteti tjetër të përafërt, i lidhur, i domosdoshëm dhe i nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve të mësipërme qoftë ai i zhvilluar për vete dhe gjithashtu i zhvilluar dhe për llogari të të tretëve.

Objekti social mund të zhvillohet në mënyrë direkte por edhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara ose të lidhura që zhvillojnë aktivitet e renditura më sipër.

Në mënyrë të rastësishme dhe ekskluzivisht për të arritur qëllimet kryesore të shoqërisë, ajo mund të punojë me pjesëmarrës ose të jetë bashkëpunëtore në shoqëri të tjera që kanë objekt analog, të përafërt ose plotësuese të objektivave të saj.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë, me vlerën nominale të një kuote në Lekë 100 000 (njëqindmijë).

Kapitali themeltar ndahet në mënyrë të barabartë në 1 (një) kuotë).

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kuota që i përkasin ortakut si më poshtë:

Ortaku themelues: **Z.IULIU BARTUS**, lindur më 31.03.1976 me nr. **Karte identiteti nr. ZS 182987** dhe **Numer personal 1760331260017**, lëshuar në **14.04.2021** deri më **31.03.2031**, me adresë në Rr."Sami Frasheri" P.Titan Konstruksion, K. 10, Nr.34 – Tiranë, i cili do të ketë **1 (një) kuota** me një vlerë totale në Lekë prej 100.000 (njëqindmijë), që përbën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet ose mund të rritet dhe është plotësisht i likuiduar dhe i nënshkruar.

## NENI 6

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali i saj fillestar, nga pasuri të luajtshme ose të paluajtshme dhe nga të tjera pasuri që janë dhënë dhe do të jepen të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë.

## NENI 7

Kuotat e kapitalit themeltar do të derdhen nga ortaku në Bankë, në llogarinë bankare në emër të shoqërisë, dhe derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarive të shoqërisë.

## NENI 8

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakut të saj. Asambleja e përgjithshme vendos në bazë të ligjit shpërndarjen ose investimin e fitimeve duke vendosur dhe mënyrat.

## NENI 9

Shoqëria tregtare **STAR CLOUD SH.P.K** është përdoruese dhe mbajtëse e pasurisë së krijuar. Ajo mund të marrë dhe të ushtrojë të drejta të tjera, materiale dhe jo materiale, përfshirë dhe të drejtën e shitjes së pasurisë së krijuar të tretëve.

Në Republikën e Shqipërisë, **STAR CLOUD SH.P.K.**, gëzon të drejta të barabarta me çfarëdoqj personi tjetër juridik, shqiptar ose të huaj, në bazë të legjislacionit në fuqi.

## NENI 10

Shoqëria **STAR CLOUD SH.P.K.**, vepron në regjimin e pronësisë private dhe merr përsipër të gjitha detyrimet dhe të drejtat brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët marrin përsipër rrezikun e aktivitetit të shoqërisë vetëm brenda limitit të kapitalit themeltar të investuar në të.

## NENI 11

### DREJTIMI DHE MENAXHIMI I SHOQËRISË

Bëjnë pjesë në detyrimet dhe kompetencat e ortakëve, të mbledhur në asamble të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në këtë statut. Ndër këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi në aktin e themelimit dhe në statut;

Bëjnë pjesë në detyrimet dhe kompetencat e ortakëve, të mbledhur në asamble të përgjithshme, të gjitha ato që janë parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe të listuar në këtë statut. Ndër këto detyra përfshihen:

1. ndryshimi në aktin e themelimit dhe në statut;
2. miratimi i buxhetit vjetor, të veprimtarisë së administrimit, të inventarit, të bilancit të llogarisë vjetore;
3. emërimi dhe shkarkimi i administratorëve ortakë e jo-ortakë dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tyre, duke përcaktuar se qoftë për emërimin ashtu edhe për shkarkimin nuk do të jetë e domosdoshme të jepet shprehimisht një shkak;
4. miratimin i huave dhe i garancive; aprovimin e kredive deri në ekuivalentin e 1.000.000 (një milion) Euro ose ekuivalentin e saj në valuta të tjera ndërkombetare sipas PTR 2349098 dhe garancive;
5. miratimi i tarifave për shërbimet që kryen shoqëria;
6. përcaktimi i formës së vulës dhe të markës së shoqërisë;
7. zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë;
8. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
10. vendimin lidhur me krijimin apo mbylljen e filialeve, përfaqësimeve ose e agjencive të shoqërisë;
11. vendimin për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

15. vendimin për miratimin dhe ndryshimin e rregullave të procedurës për mbledhjen e asamblesë;
16. vendimin për dhënien ose revokimin e prokurave të përfaqësimit të shoqërisë;
17. vendimin për shitjet e kuotave të shoqërisë;
18. vendimin për çështje të tjera të parashikuara me ligj apo nga statuti;
19. marrjen e çdo vendimi tjetër që nuk i është deleguar ndonjë organi tjetër;
20. në shtim të kompetencave normale të asamblesë së ortakëve, në baze të ligjit në fuqi, janë kompetencë e ortakut vendimet që kanë të bëjnë me aktet e blerjeve ose të dhëniet e të drejtave reale imobiliare ose të dhëniet e garancive reale personale.

## NENI 12

### Administratori i shoqërisë do të jetë :

**Z.IULIU BARTUS**, lindur më 31.03.1976 me nr. Karte identiteti nr. **ZS 182987** dhe Numer personal **1760331260017**, lëshuar në **14.04.2021** deri më **31.03.2031**, me adresë në **Rr."Sami Frasheri" P.Titan Konstruksion, K. 10, Nr.34 – Tiranë**, madhor me aftësi të plotë për të vepruar, i cili do të ushtrojë të gjitha veprimtaritë e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë duke aplikuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme konform me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Administratori emërohet për 5 (pesë) vjet duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR, me të drejtën për tu rizgjedhur, nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos që ta shkarkojë atë nga kjo detyrë para përfundimit të këtij mandati, ose në rastin e paraqitjes me përpara të dorëheqjes nga ana e administratorit sipas procedurave të parashikuara nga ligji.

administratorëve në detyrë, të gjithë administratorët do të jenë veç e veç ose bashkërisht përgjegjës për përmbushjen e funksioneve të dhëna nga ana e ligjit administratorëve.

### NENI 13

Administratori kryen detyrat e ngarkuara nga ortakët e shoqërisë në këtë statut dhe të gjitha ato detyra të parashikuara dhe të përcaktuara nga ligji. Midis këtyre detyrave janë të përfshira ato që renditen më poshtë:

1. të veprojë dhe të nënshkruajë në emër të shoqërisë;
2. të përpunojë rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe një plan biznes për vitin financiar, i cili do të aprovohet në asamblenë e përgjithshme;
3. punësimet, pagat, pushimet nga puna, masat disiplinore në ngarkim të punonjësve, miratimin e kërkesave për dorëheqje nga vendi i punës;
4. të përpunojë dhe të prezantojë për miratimin para asamblesë së përgjithshme raportet mbi aktivitetin e shoqërisë dhe bilancin e mbylljes së vitit ushtrimor të vitit të kaluar, në bazë të asaj që është parashikuar nga ligji;
5. të mbajë në rregull regjistrin e vendimeve të asamblesë së përgjithshme;
6. administratori (ose administratorët nëse do të emërohen më vonë të tjerë) është përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe të tretëve për shkeljet e ligjit ose të normave të statutit që mund të ndodhin gjatë ushtrimit të kompetencave të tij, në bazë të ligjit shqiptar;
7. të kryejë të gjitha aktivitetet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke aplikuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
8. të përfaqësojë Shoqërinë tregtare;

9. të merret me mbajtjen e dokumenteve dhe të librave të llogarive të shoqërisë me korrektesë dhe saktësi;
10. të kryejë regjistrimin dhe të dërgojë të dhënat e nevojshme të shoqërisë, ashtu sic është parashikuar nga ligji për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
11. të kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji dhe nga statuti;
12. ti raportojë asamblesë së përgjithshme realizimin dhe kryerjen e politikave tregtare dhe për sa i përket realizimit të aksioneve specifike të një rëndësie të veçante në aktivitetin e shoqërisë tregtare;
13. të emërojë financiarë me licencë shtetërore, likuidatorë dhe konsulentë për problemet e shoqërisë. Financieri me licencë shtetërore jep llogari në mënyrë të rregullt të tregueseve financiar, çdo tremujor, gjashtëmujore dhe vjetor për aktivitetin e shoqërisë;
14. të administrojë me korrektesë dhe vëmendje shoqërinë;
15. të kontrakttojë marrëveshje me të tretët në limitet e objektit të aktivitetit dhe të kompetencave të përcaktuara nga ortakët;
16. të aplikojë rregulloren e brendëshme të shoqërisë;
17. të përgjigjet për dëmet e sjella shoqërisë nga veprimet e tij;
18. të paguhet për punën që kryen në bazë të marrëveshjeve të bëra me ortakët themelues;
19. të informohet dhe të bëjë propozime për çfarëdolloj gjëje që e vlerëson të dobishme për shoqërinë;
20. të kryejë të gjitha aktivitetet bankare që kanë lidhje me llogarinë e shoqërisë;
21. administratori ka të drejtë dhe detyrim për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, në bazë dhe duke zbatuar dispozitat e neneve 12 dhe 13 tëkëtij statuti dhe të ligjit ku nuk është e përfshirë në statut.



## NENI 14

### DETYRIMET DHE TE DREJTAT E SHOQËRISË

Shoqëria ka të drejtë:

1. të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
2. të sigurojë pasurinë e tij;
3. të marrë kredi në lekë dhe në valutë të huaj nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të normave ligjore;
4. të përfitojë nga favoret që i njej legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera ;
5. të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
6. të punësojë punëtorë, vendas ose të huaj;
7. të eksportojë lirisht valutën që ka realizuar nga fitimet e saj.

## NENI 15

Shoqëria ka për detyrë:

1. të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
2. të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
3. të sigurojë punonjësit e saj;
4. të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktore ndaj cilitdo;

5. të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.

#### NENI 16

#### RAPORTET EKONOMIKE DHE FINANCIARE TË SHOQËRISË

I gjithë aktiviteti i shoqërisë përplotësimin e objektit të saj, pasqyrohet në bilancin e saj ekonomik.

#### NENI 17

Në selinë e shoqërisë mbahet dokumentacioni financiar, në bazë të të cilit, brenda datës 31 Mars të çdo viti hartohet bilanci.

#### NENI 18

#### DISPOZITA TE VECANTA

Shoqëria ka vulën e saj dalluese dhe mund të ketë një markë të saj.

#### NENI 19

#### TRASFORMIMI DHE SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Shendrimi i shoqërisë STAR CLOUD SH.P.K., në shoqëri të tipeve të tjera, mund të bëhet me vendim të ortakut themelues sipas mënyrave të parashikuara nga ligji.

#### NENI 20

Shpërbërja e shoqërisë, mund të vijë për shkaqet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr.

9901 datë 14.04.2008 dhe për arsyet si më poshtë:

- humbja e kapitalit të shoqërisë;
- pamundësi për veprim;

- me vendim të Ortakut të vetëm.

Në këto raste ortaku i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë duke u përcaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë deri sa ajo t'u dorëzohet personave përkatës fizikë e juridikë, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet që ka shoqëria ndaj personave të tretë.

Në rast se fondet e disponueshme, rezultojnë të pa mjaftueshëm, për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë, likuidatori mund t'i kërkojë ortakut themelues të shoqërisë që të derdhë tërësisht kuotat që i takojnë atij.

#### NENI 21

Përsa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, do ti referohet legjislacionit shqiptar si edhe ndryshimeve të mëvonshme që do të kryen nga asambleja e përgjithshme e ortakëve sipas ligjit, në formën e aktit publik.

#### NENI 22

Statuti përpilohet në 3 (tre) kopje, të nënshkruara rregullisht nga ortaku.

**ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**STAR CLOUD SH.P.K.**

**Z. IULIU BARTUS**



TIRANA  
26. APRIL 2021